



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 101

Prishtinë, më 19.2.2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Haki Demolli, Mufera Shinik Ardian Gjini, Arsim Bajrami, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi dhe Sreten Ivanoviq

Mungoi: Behar Selimi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Urim Salihu, Zsolt Bartfai dhe Petrit Hysaj – OSBE, Valdete Daka, Adnan Rustemi, Bajram Latifi, Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Binak Vishaj dhe Florian Dushi – KQZ, Sefadin Kllokoqi – D4D, Suad Sernaxhaj – Vizitor, Lumnije Murati – ZPRK, Shukri Sylejmani-PZAP, Ismet Kryeziu-Demokracia në Veprim, Bardhe Shkreli – RTK-Radio, Brikena Tozi- Ambasada Belge, Besarta Salihu – Kuvendi, Marie Nikolla – Rrokum TV, Vlora Nushi – OPA-UNMIK, Sylë Ahmeti – Kosova Sot, Dragana Dukiq, Shqipe Hetemi – Epoka e Re dhe Albert Krasniqi-KIPRED.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Komisioni vazhdoi me shqyrtimin e Projektligjit me pjesët e fundit të mbetura, veçmas u diskutua për nenet që kanë të bëjnë me votimin jashtë Kosovës, votimi i personave me nevoja të veçanta, numërimi dhe përpilimi i rezultateve, vlefshmëria e fletëvotimeve, transportimi i materialit zgjedhor, sistemi zgjedhorë-zonat, ndarja e vendeve, Certifikimi dhe shpallja e rezultateve, Paneli zgjedhor për ankesa dhe parashtresa, Procedurat e PZAP-it dhe Shkeljet zgjedhore.

Për këtë diskutuan: Arben Gashi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Haki Demolli, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, si dhe përfaqësuesit nga KQZ-ja dhe Shoqëria Civile. Diskutimet e plota janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se obligimet që ka marrë KQZ-ja për riformulim të dispozitave të Projektligjit, të identifikuar nga takimet e mbajtura më 14,18 dhe 19 shkurt 2014, t'ia dërgojë Komisionit për Legjislacion më së largu deri më. 24.2.2014 në orën 12:00.

Komisioni vendosi të shtrojë drekë pune për anëtarët e Komisionit, stafin dhe personat e ftuar nga shoqëria civile, kurse mbledhja e radhës për shqyrtimin e Projektligjit mbahet më. 26.2.2014.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetar i Komisionit
Arben Gashi
